



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

KOMENTAR LIGJOR Nr. 4



Botimi i këtij Komentari u mundësua nga OSBE – Prezenca në Shqipëri
Tetor 2007



PËRMBAJTJA

	faqe
1. Përshëndetje e Inspektorit të Përgjithshëm	2 - 5
2. Si mund të evidentojmë, parandalojmë dhe zgjidhim konfliktin e interesave (<i>Raste konkrete</i>)	6 - 20



*Përshëndetje e
Inspektorit të Përgjithshëm*





REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORIATI I LARTE I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE PASURIVE

Të nderuar përfaqësues të njësive vendore!

Takimet tona besoj se i kanë shërbyer më mirë qëllimit që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, në bashkëpunim me OSBE-në, ka ndërmarrë për ndërgjegjësimin e zyrtarëve të zgjedhur vendorë për zbatimin e ligjit, për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Ligji "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", është në vijim të ligjit "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" dhe njëkohësisht është instrument për të evidentuar edhe rastet, se kur një zyrtar publik mund të ndodhet përpara riskut të rënies në konflikt interesi.

Dëshiroj të them se ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" e ka parashikuar Inspektoratin e Lartë si Autoritetin Qendror Përgjegjës për zbatimin e tij. Kompetencat, roli dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive rregullohen kryesisht në Kreun VI të ligjit, e përkatësisht në nenet 41 e 42 ku janë renditur një sërë detyrash dhe përgjegjësisish, siç janë:

- Drejtimi, përmirësimi i politikave, i mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave.

Në këtë drejtim, janë bërë përpjekje që të unifikohen politikat dhe mekanizmat që do të aplikohen nga institucionet e zgjedhura e në tërësi ato publike për parandalimin e konfliktit të interesave. Cilido institucion i zgjedhur publik, në varësi të natyrës së aktivitetit të tij, duhet që të parandalojë vetë mundësinë e rënies në konflikt interesi. Për këtë arsye, cilido nga Ju nën autoritetin e funksionit ligjor, duhet të ndërtojë edhe mekanizmat e brendshëm nëpërmjet akteve, rregulloreve për të bërë të mundur funksionimin normal dhe kujdesin për të evituar rast pas rasti e në kohën e duhur çdo veprimtari të kundërligjshme. Ndërtimi i politikave të qarta dhe të unifikuara për parandalimin e konfliktit të interesave, përbën një detyrë parësore për institucionin tonë e njëkohësisht edhe për Ju, duke synuar aplikimin e standardeve të njëjta për çdo rast, e parë kjo në raport me vendin, pasojën, funksionin dhe shkaqet e lindjes së konfliktit. Në ndihmë të këtij qëllimi, do t'u vijë vënia në dispozicion nga ana e ILDKP-së e manualeve unifikuese për kuptimin sa më të lehtë të rastit analog të ndeshur gjatë veprimtarisë së njëjtë institucionale, do të keni konsulencë nga cilido punonjës i ILDKP-së, si edhe nga stafi i ekspertëve tanimë të njohur për parandalimin e konfliktit të interesave.

ILDKP në tërë këtë periudhë, verpimtarinë e saj, të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve e të autoriteteve përgjegjëse, i ka vënë vazhdimisht në vëmendje të organeve të medias me qëllimin e mirë që për gjithçka dhe gjithkush të bjerë në dijeni të kërkesave ligjore, e për rrjedhojë të mësojë se nga mospërmbushja në kohën e përcaktuar nga ligji, domosdoshmërisht mbetet të zbatohen edhe masa administrative.

- Një element tjetër i punës së ILDKP-së ka qenë dhe është forcimi i kapaciteteve për administrimin e konfliktit të interesave në institucionet publike. Nga eksperiencia e deritanishme, jemi munduar që të realizojmë trajnim të Autoriteteve Përgjegjëse, kudo ku ato ndodhen. Në një periudhë afro 4-veçare jemi mbledhur disa herë me qëllim zbatimin sa më mirë të ligjit, ofrimin e shërbimit

të konsulencës ndaj subjekteve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj Inspektoratit të Lartë. Me qëllim ruajtjen e vlerave të deritanishme për të gjitha trajnimet e kryera, kemi kërkuar dhe këmbëngulur pranë të gjithë titullarëve të institucioneve vendore e të administratës publike në përgjithësi që Autoriteti ose strukturat përgjegjëse (drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni, sipas pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005), të mbeten dhe të respektohen si autoritet që do të merren drejtpërsëdrejti me evidentimin, zbatimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave. Kështu, hartimi i programeve të trajnimit dhe ngritja profesionale e tyre do të jetë një proces në vazhdimësi e për rrjedhojë, do të bëjë më të lehtë përgjegjësinë për titullarin dhe gjithë institucionin që përfaqëson, por më pozitive do të jenë raportet e tyre me Inspektoratin e Lartë.

- Element tjetër i punës sonë është edhe monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të këtij ligji në tërësi për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, si edhe të respektimit të këtij ligji në raste të veçanta apo rast pas rasti të konfliktit të interesave. Si institucion qendror përgjegjës, Inspektorati i Lartë duhet të zhvillojë edhe në aspektin e vlerësimit të punës së Autoriteteve Përgjegjëse pranë institucioneve vendore publike, për mënyrën e zgjedhjes, masat e marra, procedurat e aplikuara dhe pasojat e krijuara. Një gjë e tillë mund të sjellë edhe vështirësi, por ne mendojmë se zbatimi i ligjit dhe garantimi i parimit të shmangies së konfliktit të interesave do të jenë një qëllim dhe synim i institucionit sa herë që do të paraqitet një gjë e tillë. Në këtë monitorim, duhet të mbahen në konsideratë nga ana Juaj edhe elementët e kërkuar ligjorë sikurse janë:
 - Regjistrimi periodik i interesave private të zyrtarëve, sipas kreut II, Seksioni 2 të këtij ligji;
 - Respektimi i modelit të deklarimit rast pas rasti të interesave private, si edhe të regjistrimit të të dhënave që lidhen me një konflikt të tillë;
 - Këshillimi i zyrtarëve të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si edhe për regjistrimin periodik të interesave.

Nisur nga praktika e deritanishme më duhet të përsërit se procesi i këshillimit është një nga instrumentet kryesorë për parandalimin dhe shmangien e mundësisë së rënies në konflikt interesi. Ne kërkojmë të ndërtojmë struktura efçente dhe profesionale, të cilat t'u japin mundësinë dhe t'u ofrojnë të gjithë zyrtarëve informacionin e nevojshëm dhe këshillimin përkatës për çdo kërkesë të tyre, në mënyrë që në asnjë rast dhe me asnjë mënyrë zyrtari të ndihet i painformuar apo i panjohur me detyrimet ligjore, të cilat në një kohë të dytë mund të sjellin pasoja të dëmshme për të dhe për institucionin që përfaqëson.

- Ndër kompetencat më të rëndësishme që Inspektorati i Lartë kryen aktualisht dhe do të vazhdojë të kryejë, është edhe verifikimi dhe hetimi administrativ i deklarimeve periodike të interesave dhe verifikimi e hetimi administrativ i konfliktit rast pas rasti të interesave; si edhe të ndalimeve e kufizimeve të interesave, të përcaktuara në Kreun III të këtij ligji, me kërkesë të institucionit publik a epror, ose kur e konsideron të nevojshme, edhe me nismën e tij. Aktualisht, verifikimi dhe hetimi administrativ realizohet për një numër të madh deklarimesh të pasurisë dhe detyrimeve financiare të zyrtarëve. Me daljen e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, ky proces ka një rikonceptim dhe mundësi më të madhe për të hetuar, duke i dhënë më shumë mundësi institucionit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të hetojë dhe auditojë si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave” është një instrument shumë i mirë dhe plotësues i procesit të deklarimit të pasurive dhe i realizimit të transparencës e bashkëpunimit me publikun e gjerë në luftën kundër korrupsionit. Këto ligje, së bashku me institucionet e tjera shqiptare, me shoqërinë civile, me organet e medias dhe me publikun, do të shërbejnë si një ndihmesë dhe lehtësi për institucionet që Ju do të drejtoni mbi votbesimin e marrë nga zgjedhësit në kryerjen sa më mirë të detyrave tuaja. ILDKP-ja është në detyrim dhe në predispozicion ligjor për bashkëpunim në zhvillimin e njohjen sa më mirë të punës dhe problematikës së ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimit e kontrollit të pasurive.

Ju faleminderit!

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

FATMIRA LASKA



**Si mund të evidentojmë, parandalojmë
dhe zgjidhim konfliktin e interesave**

(Raste konkrete të zgjedhura nga seminaret dhe trajnimet)

Rasti 1

Zyrtari LN i bashkisë X, është caktuar anëtar i komisionit të një tenderi. Në këtë tender paraqitet edhe shoqëria A, në të cilën ky zyrtar ka aksione. Për këtë arsye, zyrtari jep dorëheqjen si anëtar i komisionit të tenderit dhe zëvendësohet me një zyrtar tjetër. Shoqëria A vazhdon të jetë pjesëmarrëse në tender duke qenë e përfaqësuar nga bashkëshortja e zyrtarit, që ka dhënë dorëheqjen.

Pyetja: A është zyrtari i larguar në konflikt interesi në këtë rast dhe a ka të drejtë shoqëria A të marrë pjesë në tender?

Përgjigje:

Kufizimet për zyrtarët ndryshojnë sipas funksioneve.

Pika 2 e nenit 21 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 përcakton se *“Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, .. të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ... ndalimi (i lidhjes së kontratave) ... zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, me bashkinë, ... ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie.”*

Ekziston një ndalim i natyrës “absolute”, që lidhet vetëm me kategorinë e zyrtarit, pra me funksionin e tij dhe nuk varet aspak nga kompetenca apo jo thelbësore e përcaktuese e zyrtarit në lidhjen e kontratave, madje ky ndalim zbatohet edhe nëse zyrtari nuk merr pjesë apo nuk ka mundësi të marrë pjesë në lidhjen e një kontrate.

Në bashki, këta zyrtarë janë:

1. kryetari i bashkisë;
2. nënkryetari i bashkisë;
3. anëtarët e këshillit bashkiak;
4. zyrtarët e nivelit të lartë drejtues të kësaj bashkie¹.

Kjo do të thotë që, zyrtarët vendorë të sipërpërmendur janë të përjashtuar nga mundësia e lidhjes së kontratave me institucionin vendor ku ata ushtrojnë funksionin.

Në variantin e parë; nëse zyrtari LN² i dorëhequr nga komisioni i tenderit, kryen një nga katër funksionet e lartpërmendura, është në konflikt interesi, në qoftë se shoqëria, në të cilën ai ka aksione, merr pjesë në tender.

Shkronja b) e nenit 26 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” përcakton se *“Autoriteti kontraktor refuzon një ofertë ose kërkesë për pjesëmarrje në tender, nëse ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit.”*

Në këtë rast, **shoqëria A duhet skualifikuar nga pjesëmarrja në procedurat e mëtejshme të prokurimit.**

Në variantin e dytë; kur zyrtari i dorëhequr kryen funksion specialist në bashki, pra nuk ushtron asnjë nga funksionet e përcaktuara më sipër, përsëri konflikti i interesit ekziston i natyrës relative (është konflikt i rastit).

Pra, për zyrtarët e tjerë të bashkisë, ndalimi i lidhjes së kontratave është i natyrës “relative”.

Ndalimi i natyrës “relative” nuk është gjë tjetër veçse konflikti rast për rast i interesit, për një vendimarrje që përfundon në lidhjen e një kontrate.

¹ Koncepti “nivel i lartë drejtues” i një zyrtari të një njësie të qeverisjes vendore, lidhur me nenin 21 pika 2, ka kuptim relativ brenda për brenda atij institucioni, sipas përcaktimit statutor të vetë institucionit. Ky koncept është i ndryshëm nga një institucion në tjetrin.

² Duke prezumuar se zyrtari LN është një nga katër zyrtarët e përmendur më sipër.

Pika 3 e nenit 21 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 përcakton se “...ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik, apo ndonjë formë tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

- a) zyrtari, që ushtron funksionet në këtë institucion publik ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;
- b) ky zyrtar ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative ...”

Zyrtari LN është zyrtar i nivelit të ulët ose të mesëm. Në këtë rast, arsyetimi duhet të bëhet në bazë të pikës 3 të nenit 21 (cituar më sipër).

A ka zyrtari LN kompetencë thelbësore në përcaktimin e kushteve të kontratës? Cili është roli i tij në përgatitjen e procedurave të tenderit etj.?³

Nëse përgjigjet e pyetjeve a) dhe b) janë pozitive, atëherë zyrtari LN është në kushtet e konfliktit të interesit dhe shoqëria A nuk mund të lidhë kontratë me bashkinë.

Në këtë rast, mënyra e vetme e zgjidhjes së konfliktit të interesit, është mospërfshirja e zyrtarit LN në vendimmarrje. **Në të kundërt, nëse zyrtari LN përfshihet në vendimmarrje, kontrata do të jetë e pavlefshme.**

- - -

Rasti 2

Vjehri i kryetarit të bashkisë X, ka pjesë në kapital në një shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit. Kjo shoqëri paraqitet për konkurim në bashkinë, ku është kryetar dhëndrri i njërit prej bashkëpronarëve.

Pyetja: A mund të lidhet kontrata mes bashkisë dhe kësaj shoqërie? A është në konflikt interesi kryetari i bashkisë?

Përgjigje:

- Në rastin konkret, zyrtari klasifikohet si zyrtar i nivelit të lartë drejtues, sepse është kryetari i bashkisë dhe rrjedhimisht përfshihet në ndalimin e përgjithshëm të parashikuar nga pika 2 e nenit 21 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005.
 - Vjehri është person i lidhur dhe për të gjen zbatim i njëjti ndalim, si për vetë zyrtarin.
- Neni 24 përcakton se “Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 pikat 2 ... përbëhet nga bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es”.

Për rrjedhojë, kjo kontratë nuk mund të lidhet dhe nëse është lidhur, ajo duhet të konstatohet e pavlefshme, duke u zbatuar njëkohësisht sanksionet përkatëse mbi personat përgjegjës. Gjithashtu, duhet të rregullohen edhe pasojat, që kjo kontratë mund të ketë sjellë.

- - -

Rasti 3

Kryetari i bashkisë X, është njëkohësisht dhe kryetar i KRRT-së, si dhe personi i vetëm që mund të nënshkruajë lejet e ndërtimit. KRRT-ja shqyrton kërkesën e vëllait të kryetarit të bashkisë, për dhënie leje

³ Për të gjykuar nëse ka konflikt rast pas rasti duhet të ndiqen 8 hapa metodologjikë, të cilët janë shpjeguar hollësisht në faqen nr. 17 të Manualit të ILDKP-së dhe ITAP-it “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.

ndërtimi të një pallati banimi, në truallin pronë e trashëguar e kryetarit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij.

Pyetja: A është kryetari i bashkisë në konflikt interesi në rast se nënshkruan lejen e ndërtimit, të dhënë për vëllain e tij?

Përgjigje:

Leja e ndërtimit do të shqyrtohet (do të jepet ose jo) nga KRRR-tja, e cila është organ kolegjal. Në këtë organ kolegjal kryetari i bashkisë ka vetëm një votë. Megjithatë, për të shmangur konfliktin rast pas rasti të interesit, kryetari i bashkisë duhet të shmanget nga vendimmarrja për dhënien e lejes së ndërtimit.

Përsa i përket nënshkrimit të lejes së ndërtimit, kryetari i bashkisë nuk është në konflikt interesi, pasi pika 6 e nenit 37 të ligjit parashikon se *“Zyrtari lejohet të ushtrojë funksion dhe të kryejë detyrën me kusht që konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:*

a) *kur ai është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;...*

b) *dhe kur:*

i) *nuk është i mundur as tjetërsimi i interesit privat, ...për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);*

ii) *nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, ai të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një **kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga institucionet e ngarkuara me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.”***

- - -

Rasti 4

Shitja e pronave publike tek një zyrtar i bashkisë, a mund të trajtohen e njehsohen me rastet e pjesëmarrjes në tender. Kjo, në vështrim të ekzistencës ose jo të konfliktit të interesit?

Përgjigje:

Rastet e shitjes së pronave publike tek një zyrtar i bashkisë, do të trajtohen si rastet e pjesëmarrjes në tender, përsa i përket ekzistencës ose jo të konfliktit të interesit.

Analiza e rastit do të bëhet si në rastin 1, të trajtuar më sipër.

- Kërkohen të dhëna për funksionin e zyrtarit.
- Ekziston një ndalim i natyrës “absolute” për zyrtarët e mëposhtëm:
 - kryetari i bashkisë;
 - nënkryetari i bashkisë;
 - anëtar i këshillit bashkiak;
 - zyrtar i nivelit të lartë drejtues të bashkisë;

Për nivelet e tjera të zyrtarëve, trajtimi do të bëhet sipas natyrës “relative”, pra analizohet roli, detyrat, kompetencat konkrete të zyrtarit në procesin e ankandit/shitjes së pronave publike, sipas hapave metodologjike të shpjeguara në Manualin e ILDKP-së dhe ITAP-it “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.

- - -

Rasti 5

Bashkia e qytetit X njofton se do të liçensojë 20 taksi të tjera për qytetin. 30 persona paraqesin dokumentet në bashki. Në përfundim të fazës së parë konstatohet se të gjithë kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u liçensuar dhe njëri nga këta është vëllai i kryetarit të bashkisë.

Pyetja: Në rast se kryetari i bashkisë liçenson vëllain, a është në kushtet e konfliktit të interesit?

Përgjigje:

Në këtë rast, do të arsyetohet si në shembullin e trajtuar në rastin 3. Pra, kryetari i bashkisë nuk është në konflikt interesi, në bazë të pikës 6 të nenit 37 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005.

- - -

Rasti 6

Zyrtari A për shkak të funksionit që kryen, mbart detyrimin për deklarim të interesave private periodike në ILDKP.

Pyetja: Nëse ky zyrtar, po brenda të njëjtit vit kalendarik, emërohet në një detyrë tjetër, (sipas së cilës vazhdon të mbetet subjekt deklarimi në ILDKP), a duhet të ribëjë deklarimin e interesave private?

Përgjigje:

Zyrtari nuk do të plotësojë apo të përsëritë deklarim periodik (për të njëjtën periudhë), por nëpërmjet Autoritetit Përgjegjës (drejtorit të burimeve njerëzore), të institucionit ku ka kryer e do të vazhdojë të kryejë funksionin dhe/ose kalon në një institucion tjetër, duhet të njoftojë me shkrim Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP-në) për ndryshimin e funksionit a të institucionit të zyrtarit.

- - -

Rasti 7

A mundet kryetari i bashkisë të ketë liçensë për ushtrimin e një aktiviteti privat?

Përgjigje:

Kufizimet për kryetarin e bashkisë janë parashikuar në nenin 29 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesit...*” dhe janë të njëjta edhe për kryetarin e komunës dhe të këshillit të qarkut.

Sipas kësaj dispozite, kryetari i bashkisë:

- nuk mund të jetë drejtues i organizatave fitimprurëse⁴, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të bashkisë;
- nuk mund të jetë anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të bashkisë;
- nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijojnë të ardhura në formën e:
 - o personit fizik tregtar;

⁴ Termi “organizatë fitimprurëse” përfshin të gjitha format e organizimit në shoqëri tregtare (sh.a., sh.p.k., komandite, kolektive), në forma të thjeshta të organizimit sipas Kodit Civil, si dhe në forma të tjera të përhershme apo të përkohshme të organizimit për qëllim fitimi, të cilat nuk kërkojnë domosdoshmërisht fitimin e personalitetit juridik, për efekt të regjistrimit (kontrata angazhimesh, konsorciume të përkohshme etj.).

- ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme;
- profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të liçencuar;
- konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të bashkisë;
- nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.

Pra, kryetari bashkisë nuk mund të ushtrojë një aktivitet privat, që lidhet me liçencimin e tij si ekspert.

- - -

Rasti 8

A mund të jenë dy vëllezër anëtarë të të njëjtit këshill bashkiak?

Përgjigje:

Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 nuk parashikon ndonjë ndalim të shprehur për këtë rast. Megjithatë, pika 2 e nenit 5 parashikon se *“Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.”*

Ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” parashikon në nenin 25 të tij se *“Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat që janë me njëri-tjetrin bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrri e vjehrra me nusen dhe dhëndërin.”*

Për këtë arsye, dy vëllezër nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill bashkiak.

- - -

Rasti 9

Një drejtor në bashkinë X, është edhe anëtar i këshillit bashkiak. A është e lejueshme kjo?

Përgjigje:

Edhe ky rast trajtohet nga ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Neni 25 i ligjit trajton rastet e papajtueshmërisë me funksionin e këshilltarit dhe shprehet se *“Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:*

- a) ...;*
- b) ...;*
- c) funksionin e nëpunësit të administratës së komunës ose bashkisë përkatëse;”*

Është e qartë se, zyrtari që ushtron funksionin e drejtorit në bashki, nuk mund të jetë edhe anëtar i këshillit bashkiak.

- - -

Rasti 10

Shoqëria tregtare B merr pjesë në një tender të organizuar nga bashkia e qytetit X. Në këtë shoqëri është aksionere edhe vjehrra e kryetarit të bashkisë, e cila ka në pronësi vetëm 1 % të aksioneve të shoqërisë. Me shpalljen e tenderit dhe dorëzimin e ofertave, një nga konkurrentët ngriti pretendimin se shoqëria

tregtare B nuk mund të marrë pjesë në tender, për shkak të konfliktit të interesit dhe ndalimit të përcaktuar nga neni 21 i ligjit PKI.

Pyetja: A ka të drejtë konkurrenti në pretendimin e ngritur? Si do të procedohet më tej?

Përgjigje:

- Në pikën 2 të nenit 21 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 PKI, ekziston një ndalim absolut për kryetarin e bashkisë në lidhjen e kontratave me bashkinë ku ushtron funksionin.
- I njëjti ndalim ekziston edhe për personat e lidhur me kryetarin e bashkisë, të përcaktuar në nenin 24⁵ të ligjit.

Për rrjedhojë, kjo kontratë nuk mund të lidhet dhe shoqëria tregtare B nuk duhet të lejohet të marrë pjesë në këtë tender.

- - -

Rasti 11

Zyrtari A është punësuar në bashki, në pozicionin e specialistit në Sektorin e Statistikave. Menjëherë pas lidhjes së kontratës së punës, Drejtori i Burimeve Njerëzore të bashkisë, i cili është njëkohësisht edhe autoriteti përgjegjës i bashkisë, i kërkon zyrtarit A nënshkrimin e autorizimit, në bazë të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”.

Zyrtari A refuzon nënshkrimin e këtij autorizimi me arsyetimin se është zyrtar i nivelit të ulët pra, nuk është subjekt i deklarimit të interesave private në ILDKP dhe rrjedhimisht nuk duhet të nënshkruajë asnjë autorizim.

Pyetja: A ka të drejtë Autoriteti Përgjegjës në kërkesën e tij ndaj zyrtarit A?

Përgjigje:

Autoriteti Përgjegjës i bashkisë ka të drejtë në kërkesën e tij ndaj zyrtarit A.

- Së pari, ligji përcakton në pikën 2 të nenit 10 se “Çdo zyrtar, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në një institucion publik, është i detyruar të lëshojë një autorizim, në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.” Kjo dispozitë përcakton qartë detyrimin e çdo zyrtari për të nënshkruar këtë autorizim.
- Së dyti, autorizimi, i lëshuar në bazë të nenit 10 të ligjit, nuk duhet ngatërruar me deklarimin e interesave private në ILDKP. Vetëm një pjesë e zyrtarëve, të përcaktuar në nenin 14 të ligjit PKI dhe në Udhëzimin nr.7, datë 21.2.2006 të Inspektorit të Përgjithshëm⁶, mbartin detyrimin për deklarim të interesave private në ILDKP.
- Së treti, për këtë duhet përdorur modeli i autorizimit i miratuar nga ILDKP-ja dhe i botuar në Komentarin Ligjor nr.2 të muajit shkurt 2006.

- - -

⁵ Neni 24 (pika 1) e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” parashikon se “Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 pika ... 2 ..., përbëhet nga bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es.”

⁶ Ky Udhëzim është botuar në Komentarin Ligjor nr. 2 të muajit shkurt 2006.

Rasti 12

A duhet të ketë *autoriteti përgjegjës* Këshilli Bashkiak, për administrimin e rasteve të konfliktit të interesave? A mundet *autoriteti përgjegjës* i bashkisë të trajtojë rastet e konfliktit të interesave të anëtarëve të këshillit bashkiak?

Përgjigje:

Këshilli i Bashkisë është institucion i pavarur nga bashkia, rrjedhimisht Këshilli mundet të ngrejë strukturën e tij të administrimit të konfliktit të interesave.

Megjithatë, edhe *autoriteti përgjegjës* i bashkisë mund të trajtojë rastet e konfliktit të interesave të anëtarëve të këshillit bashkiak, vetëm në rastet kur delegimi kësaj kompetence është parashikuar shprehimisht në rregulloren e Këshillit.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës i bashkisë nuk mund të ketë kompetencë të marrë masa administrative ndaj anëtarit të këshillit bashkiak.

- - -

Rasti 13

Sekretari i Këshillit Bashkiak, a mund të jetë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në bashki?

Përgjigje:

Në bazë të nenit 37 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, sekretari i këshillit është pjesë e administratës së Këshillit të Bashkisë, rrjedhimisht nuk mund t’i ngarkohen detyra që i takojnë administratës së Bashkisë.

Pra, Sekretari i Këshillit Bashkiak nuk mund të jetë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në bashki.

- - -

Rasti 14

Anëtarët e komisionit të prokurimit plotësojnë dokumentacionin, në të cilin është përfshirë tashmë edhe deklarimi për ekzistencën e konfliktit të interesit. Në këto raste, a është i nevojshëm plotësimi i deklarimit rast pas rasti të konfliktit të interesit?

Përgjigje:

Deklarimi i konfliktit të interesave nga anëtarët e komisionit të prokurimit bëhet para fillimit të procedurës së prokurimit, sipas modelit të miratuar për këtë qëllim.

Për këtë arsye, nuk është i nevojshëm të bëhet deklarim tjetër.

- - -

Rasti 15

Nëse një anëtar i Këshillit të Bashkisë është aksioner në një shoqëri tregtare, e cila merr pjesë në tenderin e organizuar nga kjo Bashki, a përbën ky rast konflikt të interesave?

Përgjigje:

Në pikën 2 të nenit 21 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, ekziston një ndalim absolut për anëtarin e Këshillit

të Bashkisë në lidhjen e kontratave me bashkinë, ku ushtron funksionin.

Për rrjedhojë, kjo kontratë nuk mund të lidhet dhe shoqëria tregtare nuk duhet të lejohet të marrë pjesë në tender.

- - -

Rasti 16

Xhaxhai i kryetarit të bashkisë është pronari i *Beta sh.p.k.*, e cila ushtron veprimtarinë e saj në fushën e ndërtimit. A përbën konflikt të interesave pjesëmarrja e *Beta sh.p.k.* në tenderin e organizuar nga bashkia?

Po nëse *Beta sh.p.k.* ka lidhur kontratë me bashkinë një vit më parë, a mund të vazhdojë kjo kontratë të jetë e vlefshme?

Përgjigje:

- Në pikën 2 të nenit 21 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, ekziston një ndalim absolut për kryetarin e bashkisë në lidhjen e kontratave me bashkinë ku ushtron funksionin.
- I njëjti ndalim ekziston edhe për personat e lidhur me kryetarin e bashkisë, të përcaktuar në nenin 24 të ligjit.
- Në rastin konkret, xhaxhai nuk klasifikohet si person i lidhur me zyrtarin, rrjedhimisht për të nuk gjen zbatim i njëjti ndalim që ekziston edhe për vetë zyrtarin.

Analizimi i këtij rasti duhet të vazhdojë në bazë të kufizimeve të tjera, të përcaktuara në pikën 3 të nenit 21⁷ të ligjit dhe konkretisht;

Pyetjet që shtrohen në këtë analizë janë:

1. A ka zyrtari kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës?
2. A ka zyrtari një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative?

Vetëm nëse përgjigjia e dy pyetjeve të mësipërme është pozitive, atëherë nxjerrim përfundimin se kryetari i bashkisë ka konflikt interesash.

Përgjigjia e pyetjes së parë është pozitive, pasi kryetari i bashkisë është titullari i institucionit, që organizon tenderin.

Për t'iu përgjigjur pyetjes së dytë duhet analizuar neni 37 i K.Pr.A., i cili përcakton se “*Asnjë punonjës i organeve të administratës nuk mund të marrë pjesë në një proces vendimmarrës administrativ apo në një lidhje kontrate ku administrata që ai përfaqëson është palë në rastet kur punonjësi ka ose/dhe dyshohet të ketë kushtet e mëposhtme:*

- a) *ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;*
- b) *bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;”*

⁷ Neni 21, pika 3: “Pavarësisht përcaktimeve të bëra në pikat 1 e 2 të këtij neni, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik, apo ndonjë forme tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

- a) zyrtari, që ushtron funksionet në këtë institucion publik ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;
- b) ky zyrtar ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Proc. Administrative, ...”

Në këtë rast, duhen analizuar dy nënçështje të tjera:

- interesi personal i kryetarit të bashkisë;
- lidhja familjare deri në shkallë të dytë.

Në bazë të kodit të Familjes, xhaxhai është lidhje familjare në shkallë të tretë, pra nuk plotësohet kushti i përcaktuar në shkronjën b) të nenit 37 të K.Pr.A. Rrjedhimisht, përgjigjia e pyetjes së dytë të pikës 3 të nenit 21 (A ka zyrtari një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative?) është negative, pra “kryetari i bashkisë nuk ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të K.Pr.A.”

Për këtë arsye, meqenëse nuk plotësohen njëkohësisht të dyja kushtet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 21 të ligjit PKI, konkludojmë se pjesëmarrja e *Beta sh.p.k.* në tenderin e organizuar nga bashkia nuk përbën konflikt të interesave për kryetarin e bashkisë.

Megjithatë, analiza duhet të vazhdojë për të parë nëse rrezikon të shfaqet konflikti në dukje i interesit. Për këtë qëllim, duhen bërë pyetjet e mëposhtme, jo më nga këndvështrimi i zyrtarit ose eprorit të tij, por nga këndvështrimi i një perceptimi të mundshëm të publikut.

- Çfarë mundësish ka që akti të ndikojë interesat private të këtij zyrtari në favor të tij?
- Çfarë mundësish ka që interesat private të zyrtarit të ndikojnë negativisht rolin e tij në vendimmarrjen për këtë akt?
- A ka një lidhje të fortë shkak-pasojë ndërmjet interesave dhe aktit, e tillë që vendimmarrja publike të mund të jetë, për këtë shkak dhe vetëm për të, një vendimmarrje e padrejtë?

Me fjalë të tjera, zyrtari ose eprori që analizon këtë rast duhet ta vendosë veten në pozicionin e një individi çfarëdo nga publiku, normalisht të informuar dhe të arsyeshëm dhe t’i bëjë vetes pyetjen e mëposhtme:

*A do të kishte ai (individi nga publiku) besim në vendimmarrjen e zyrtarit në fjalë nëse do të kishte dijeni për interesat private dhe ndërthurjen e tyre me detyrën e këtij zyrtari?*⁸

Sic është theksuar edhe në shembujt e trajtuar më sipër, duhet patur kujdes për mospërsëritjen e shpeshtë të këtij rasti. Në qoftë se *Beta sh.p.k.* merr pjesë vazhdimisht në tenderat e organizuar nga bashkia dhe shpallet fitues, atëherë kjo do të kompromentonte vetë kuptimin e kryerjes së detyrave e të ushtrimit të kompetencave nga kryetari i bashkisë.

Në këtë rast, konflikti i interesit nga një konflikt i rastit rrezikon të kthehet në konflikt të vazhdueshëm interesi dhe kontrata duhet të anulohet, duke u shoqëruar me dënimet përkatëse dhe rregullimin e pasojave, që mund të përfshijë edhe dorëheqjen apo shkarkimin nga detyra të kryetarit të bashkisë

Përgjigje e pyetjes së dytë:

Kontrata e lidhur para një viti mes bashkisë dhe *Beta sh.p.k.* është e vlefshme, pasi është lidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- - -

Rasti 17

Zyrtarja A, është anëtare e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe ka deklaruar se, bashkëshorti i saj është i punësuar në shoqërinë e telefonisë celulare “Alpha Mobile Communication” sh.a., në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Klientëve.

⁸ Të analizosh nga ky këndvështrim do të thotë të pranosh gjykimin se një person normal nga publiku, sado i avancuar të jetë sistemi i informacionit, do të absorbojë dhe do të ketë gjithnjë në funksion të gjykimin të tij për çështjen në fjalë, më pak informacion se zyrtari apo eprori i tij, pra, me fjalë të tjera, në gjykimin e ekzistencës së konfliktit në dukje të interesit, duhet të konsiderojmë të dhënat që kemi mbi qëndrimin e opinionit publik për çështje që lidhen me rastin konkret, por pa e absolutizuar atë. Zakonet dhe normat e pranuar të moralit janë gjithashtu një udhërrëfyes i mirë.

Pyetja: A ndodhet zyrtarja A në kushtet e konfliktit të interesit?

Përgjigje:

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve si organ rregullator i telekomunikacioneve, mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” si dhe ndjek politikat e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Alpha Mobile Communication është një nga operatorët, i cili ushtron veprimtarinë në sferën e juridiksionit të ERT-së.

Bazuar në shkronjën a) të pikës 6 të nenit 21 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, bashkëshortit dhe të afërmeve të tjerë deri në shkallë të dytë të subjektit A, i ndalohe lidhja e çdo kontrate me operatorët që ushtrojnë veprimtari në sferën e juridiksionit të ERT-së.

Kontrata e punës ndërmjet bashkëshortit të zyrtares A, nga njëra anë dhe *Alpha Mobile* sh.a. nga ana tjetër, është e ndaluar shprehimisht nga ky nen.

Për sa më sipër u njoftua subjekti A, e cila u paraqit në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe sqaroi se:

- Bashkëshorti është punësuar në *Alpha Mobile* sh.a, që në janar 1996 si inxhinier elektronik. Aktualisht është Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Klientëve në *Alpha Mobile* sh.a.
- Me njohjen që ka për ligjin e sipërcituar, nuk e ka ditur dhe nuk ka dijeni se punësimi i bashkëshortit në *Alpha Mobile* sh.a. përbën konflikt interesi.

Gjithashtu, subjekti A ka njoftuar ILDKP-në se si zgjidhje të konfliktit të interesit, ka pranuar vetëpërrjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, në rastet që kanë të bëjnë me operatorin *Alpha Mobile* sh.a.

Mirëpo, zgjidhja e paraqitur nga subjekti A nuk përmbush kërkesat e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, për arsyet e mëposhtme:

- Ndalimi i parashikuar nga pika 6 e nenit 21 është i natyrës “absolute” dhe lidhet vetëm me funksionin e zyrtarit dhe nuk varet aspak nga kompetenca apo jo thelbësore e përcaktuese e zyrtarit në lidhjen e kontratave, madje ky ndalim zbatohet edhe nëse zyrtari nuk merr pjesë apo nuk ka mundësi të marrë pjesë në lidhjen e një kontrate.
- Në lidhje me anëtarët e autoriteteve rregullatore, ligjvënësi ka zgjeruar sferën dhe llojet e interesave që aktivizojnë ndalimin e parashikuar në pikën 6 të nenit 21, përfshirë dhe zgjerimin e rrethit të personave të lidhur (deri në shkallë të dytë).
- Numri i vendimmarrjeve të Këshillit Drejtues të ERT-së është i madh. Çdo vendim ka impakt në tregun e telekomunikacioneve dhe ndikon drejtëpërsëdrejti në mbarëvajtjen e këtij tregu dhe të operatorëve të veçantë. Vetëpërrjashtimi paraprak i anëtares A vetëm nga vendimmarrjet që kanë të bëjnë me *Alpha Mobile*, nuk e çliron këtë zyrtare nga konflikti i interesit, pasi ligjvënësi me këtë ndalim absolut synon jo vetëm parandalimin e konfliktit të interesit, por edhe garantimin e zbatimit të një sërë parimesh, si p.sh. konkurrenca e e lirë, mbrojtja e interesave publikë, rritja e besueshmërisë së publikut në institucione etj. Madje për konkurrencën e lirë shprehet edhe vetë ligji nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në RSH”. Neni 1 i këtij ligji përcakton se “Ky ligj rregullon veprimtarinë e telekomunikacioneve në RSH dhe synon të mbrojë interesat publikë dhe të krijojë një mjedis rregullator transparent, që ndihmon nxitjen e investimeve dhe konkurrencën e lirë.” Më tej, në pikën d) të nenit 9 përcaktohet se “Kujdeset (ERT) që konkurrenca ndërmjet operatorëve të telekomunikacioneve të mbështetet në parimet e transparencës, të mosdiskriminimit dhe të ndershmërisë.” Pjesëmarrja e anëtares A në vendimmarrjet e ERT-së, edhe në rastet kur nuk vendoset drejtëpërsëdrejti për operatorin *Alpha Mobile*, është në konflikt interesi. Këto vendimmarrje, përbëjnë edhe thelbin e detyrës së këtij

zyrtari, duke e vendosur këtë të fundit në gjendje konflikti të vazhdueshëm të interesave.

Për këto arsye, ILDKP-ja i rekomandon zyrtares A zgjidhjen sa më shpejt të konfliktit të interesave, në bazë të nenit 37 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Pas këtij rekomandimi të ILDKP-së, subjekti A ka kthyer përgjigje, duke e zgjidhur konfliktin e interesit në këtë mënyrë:

- Dorëheqje nga funksioni publik si anëtare e ERT-së. Kjo dorëheqje i është paraqitur Kryetarit të Kuvendit të RSH-së.

ILDKP-ja vlerësoi zgjidhjen e dhënë nga subjekti A, si veprim i kryer në përputhje me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

- - -

Rasti 18

Bashkëshortja e Kryetarit të Këshillit të Komunës X, është e punësuar në administratën e po kësaj komune.

Pyetja: A ndodhet Kryetari i Këshillit të Komunës X në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të punësimit të bashkëshortes së tij në administratën e komunës?

Përgjigje:

Përcaktimi i ekzistencës së konfliktit të interesit kërkon të analizohet nëse, për shkak të lidhjes familjare, njëri nga zyrtarët mund të bjerë në konflikt rast për rast të interesit, qoftë edhe në dukje.

Kryetari i Këshillit të Komunës X, është kryetari i një organi të zgjedhur kolegjal. Ai nuk merr vendime i vetëm. Të gjitha vendimet merren duke respektuar parimet dhe procedurat e përcaktuara në ligjin “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Në çdo rast, Kryetari i Këshillit të Komunës duhet të zbatojë nenin 30 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” që përcakton se “1. Këshilltari nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e aktit të këshillit kur ai vetë ose bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehrrri, vjehrra, dhëndëri e nusja e tij, kanë interes pasuror ose çdo interes tjetër me çështjen që diskutohet në këshill.

2. Në çdo rast konflikti interesash zbatohen dispozitat skualifikuese, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.”

Nëse Kryetari i Këshillit të Komunës X merr pjesë në vendimmarrjet që kanë të bëjnë me bashkëshorten e tij, do të ndodhet në kushtet e konfliktit faktik të interesit.

Sa më lartë në hierarkinë e komunës të jetë e punësuar bashkëshortja, aq më i madh është numri i vendimmarrjeve, nga të cilat duhet të vetëpërfshihet paraprakisht Kryetari i Këshillit të Komunës.

Mosmarrja pjesë në një numër kaq të madh vendimmarrjesh të këshillit mund të çënojë edhe vetë thelbin e detyrës së këtij zyrtari (kryetarit të këshillit të komunës) dhe mund të shkaktojë probleme në funksionimin, *quorum*-in dhe vendimmarrjet e këshillit.

Në këtë situatë, në kushtet kur konflikti rast për rast i interesit përsëritet në mënyrë të shpeshtë, rrezikon të kthehet në konflikt të vazhdueshëm të interesit, i cili duhet trajtuar në përputhje me nenin 37 të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, pra njëri nga dy zyrtarët duhet të heqë dorë nga funksioni publik.

- - -

Rasti 19

Kryetari i komunës është njëkohësisht drejtor ekzekutiv i “B” sh.p.k., e cila ushtron veprimtarinë jashtë territorit të juridiksionit të komunës.

Pyetja: A ndodhet kryetari i komunës në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit, për shkak të pozicionit të tij në sh.p.k.?

Përgjigje:

Rastet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit për kryetarët e komunës, bashkisë dhe qarkut janë trajtuar nga neni 29 i ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, i cili përcakton se “*Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut:*

- a) *nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të tij;*
- b) *nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të liçencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.”*

Meqënëse “B” sh.p.k. ushtron veprimtarinë jashtë territorit të juridiksionit të komunës, kryetari i komunës është në përputhje me shkronjën a) të nenit 29. Sigurisht, territori ku ushtron veprimtarinë “B” sh.p.k. duhet të jetë pasqyruar në dokumentet e kësaj shoqërie, ashtu siç përcaktojnë ligjet për shoqëritë tregtare. Në vijim, duhet parë nëse kryetari i komunës është i punësuar me kohë të plotë apo të pjesshme në “B” sh.p.k.

Nëse është i punësuar me kohë të pjesshme, kryetari i komunës nuk është në konflikt interesi.

Është e rëndësishme që kjo të jetë pasqyruar në kontratën e punës dhe në dokumente të tjera të shoqërisë.

- - -

Rasti 20

Në mars 2007, AM zgjidhet Nënkryetar i Këshillit Bashkiak të qytetit. Para një viti, shoqëria tregtare T&N sh.a., në të cilën djali i zyrtarit AM është aksioner dhe zotëron 3 % të aksioneve, ka fituar tenderin e pastrimit të qytetit. Në muajin korrik 2007, kjo shoqëri kërkon një shtesë fondi prej 20 % .

Pyetja:

- a) A përbën konflikt të interesave, vazhdimi i kontratës së Bashkisë me shoqërinë tregtare T&N sh.a., nga momenti i zgjedhjes së AM-së në Këshillin Bashkiak?
- b) A përbën konflikt të interesave miratimi i shtesës së fondit prej 20 % ?
- c) A mund të rinovohet kjo kontratë?

Përgjigje:

- a) Kontrata mes Bashkisë dhe T&N sh.a. për pastrimin e qytetit, është lidhur në vitin 2006. Në këtë vit, AM nuk ishte anëtar i këshillit bashkiak të qytetit, rrjedhimisht kontrata në momentin e lidhjes ishte në përputhje me ligjin⁹. Zgjedhja e babait të njërit prej bashkëpronarëve, si anëtar i këshillit bashkiak nuk passjell pavlefshmërinë e lidhjes së kontratës. Pra, ekzistenca e kontratës nuk lidhet me ndonjë

⁹ Në këtë rast, është prezumuar se nuk ka ekzistuar asnjë shkak tjetër që çon në lindjen e konfliktit të interesit. Pra, analizohet vetëm lidhja familjare mes anëtarit të këshillit bashkiak dhe aksionerit të sh.a.-së, si faktor që mund të çojë në lindjen e një konflikti interesi.

vendimmarrje të AM-së në cilësinë e këshilltarit. Në momentin e lidhjes së kontratës, AM nuk ka qenë zyrtar, ndaj të cilit zbatohen ndalimet e parashikuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Pika 2 e nenit 21 të këtij ligji, ndalon vetëm lidhjen e kontratave, nga momenti që AM, mandatohet si anëtar i këshillit bashkiak e mbrapa, pra prej muajit mars 2007 e në vazhdim. Respektimi i kontratës së Bashkisë me shoqërinë tregtare T&N sh.a. është në përputhje me ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”

- b) Miratimi i shtesës së fondit prej 20 % nuk përbën një kontratë të re të bashkisë, por është plotësim i kontratës ekzistuese të kësaj bashkie me shoqërinë T&N sh.a. Gjithsesi, miratimi i kësaj shtese do të bëhet nga Këshilli Bashkiak i qytetit, anëtar i të cilit është edhe ati i njërit prej bashkëpronarëve të T&N sh.a. Pjesëmarrja në vendimmarrje e zyrtarit AM, në këtë rast do të jetë në konflikt interesi, në bazë të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Pika 1 e nenit 30 të këtij ligji përcakton se “*Këshilltari nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e aktit të këshillit kur ai vetë ose bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehëri, vjehërra, dhëndëri e nusja e tij, kanë interes pasuror ose çdo interes tjetër me çështjen që diskutohet në këshill.*”

Në këtë rast, konflikti i interesit mund të parandalohet nëpërmjet vetëpërfundimit paraprak të zyrtarit AM nga procesi konkret i vendimmarrjes në këshillin bashkiak.

- c) Rinovimi i kontratës do të thotë rilidhje e kontratës mes palëve. Shpeshherë, rinovimi parashikohet në kontratë. Por, lidhja e kontratës edhe një herë mes palëve, do të thotë të zbatohen ndalimet e parashikuara në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”, për shkak se një rrethanë ka ndryshuar: ati i një prej bashkëpronarëve është anëtar i këshillit bashkiak. Sipas pikës 2 të nenit 21 të ligjit PKI “*Kur zyrtari është në funksionin e anëtarit të këshillit..., ndalimi zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, me bashkinë ... ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie.*” Gjithashtu, në bazë të pikës 1 dhe 3 të nenit 24 të ligjit PKI “*Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin, të përcaktuara në këtë seksion, zbatohen edhe për personat e lidhur me të*”. Pra, nëse kontrata rilidhet do të jetë në kushtet e konfliktit të interesit. Nëse T&N sh.a. do të marrë pjesë në tenderin e organizuar nga bashkia, atëherë konflikti i interesit mund të parandalohet në një nga mënyrat e mëposhtme:
- Zyrtari AM të japë dorëheqjen si anëtar i këshillit bashkiak;
 - T&N sh.a., në bazë të ligjit “Për prokurimet publike”, të përjashtohet nga pjesëmarrja në tender;
 - Djali i zyrtarit AM, bashkëpronar i T&N sh.a. të transferojë pronësinë e aksioneve.

- - -

Rasti 21

Zyrtari BT është anëtar i KRRT-së së Bashkisë. Në muajin qershor 2007, KRRT-ja shqyrton një projekt, i cili zbatohet nga shoqëria ndërtuese X sh.p.k., në të cilën është aksionere bashkëshortja e zyrtarit BT.

Pyetja: A përbën konflikt të interesave ky rast për zyrtarin BT?

Përgjigje:

KRRT-ja është organ kolegjal dhe merr vendime me shumicën e votave. Në këtë organ kolegjal, zyrtari BT ka vetëm një votë. Megjithatë, për të parandaluar konfliktin rast pas rasti të interesit, anëtari BT duhet të shmanget nga vendimmarrja për dhënien e lejes së ndërtimit.

Në këtë rast, konflikti i interesit mund të parandalohet nëpërmjet vetëpërfundimit paraprak të zyrtarit BT nga procesi konkret i vendimmarrjes në KRRT, për dhënien e lejes së ndërtimit.

Megjithatë, duhet patur kujdes për mospërsëritjen e shpeshtë të këtij rasti. Në qoftë se X sh.p.k. merr vazhdimisht leje ndërtimi dhe zyrtari BT shmangët vazhdimisht nga vendimmarrja, atëherë kjo do të kompromentonte vetë kuptimin e kryerjes së detyrave e të ushtrimit të kompetencave nga ky zyrtar. Në këtë rast, konflikti i interesit nga një konflikt i rastit kthehet në konflikt të vazhdueshëm interesi dhe zyrtari BT duhet të japë dorëheqjen nga funksioni i tij publik.

- - -

Rasti 22

Zyrtari MN është Kryetar i Bashkisë. Ka qenë aksioner i shoqërisë ndërtuese Y sh.a. dhe në muajin prill 2007 ka shitur aksionet. Në muajin shtator 2007, kjo shoqëri paraqitet në tenderin e organizuar nga Bashkia.

Pyetja: A përbën konflikt të interesave ky rast?

Përgjigje:

Zyrtari, në rastin konkret Kryetari i Bashkisë, klasifikohet si zyrtar i nivelit të lartë drejtues dhe rrjedhimisht përfshihet në ndalimin e përgjithshëm të parashikuar nga neni 21, pika 2. Pra, Kryetari i Bashkisë nuk mund të lidhë kontratë me Bashkinë, të cilën drejton.

Por, në këtë rast, Kryetari i Bashkisë i ka shitur aksionet dhe nuk është më pronar apo bashkëpronar i kësaj shoqërie, rrjedhimisht ky zyrtar nuk është në konflikt faktik interesi.

Megjithatë, analiza duhet të vazhdojë për të parë nëse rrezikon të shfaqet konflikti në dukje i interesit. Për këtë qëllim, duhen bërë pyetjet e mëposhtme, jo më nga këndvështrimi i zyrtarit ose eprorit të tij, por nga këndvështrimi i një perceptimi të mundshëm të publikut.

- Çfarë mundësish ka që akti të ndikojë interesat private të këtij zyrtari në favor të tij?
- Çfarë mundësish ka që interesat private të zyrtarit të ndikojnë negativisht rolin e tij në vendimmarrjen për këtë akt?
- A ka një lidhje të fortë shkak-pasojë ndërmjet interesave dhe aktit, e tillë që vendimmarrja publike të mund të jetë, për këtë shkak dhe vetem për të, një vendimmarrje e padrejtë?

Me fjalë të tjera, zyrtari ose eprori që analizon këtë rast duhet ta vendosë veten në pozicionin e një individi çfarëdo nga publiku, normalisht të informuar dhe të arsyeshëm dhe t'i bëjë vetes pyetjen e mëposhtme:

A do të kishte ai (individi nga publiku) besim në vendimmarrjen e zyrtarit në fjalë nëse do të kishte dijeni për interesat private dhe ndërthurjen e tyre me detyrën e këtij zyrtari?

Siç është theksuar edhe në shembujt e trajtuar më sipër, duhet patur kujdes për mospërsëritjen e shpeshtë të këtij rasti. Në qoftë se Y sh.a. merr pjesë vazhdimisht në tenderat e organizuar nga bashkia dhe shpallet fitues, atëherë kjo do të kompromentonte vetë kuptimin e kryerjes së detyrave e të ushtrimit të kompetencave nga kryetari i bashkisë.

Në këtë rast, konflikti i interesit nga një konflikt i rastit rrezikon të kthehet në konflikt të vazhdueshëm interesi dhe kontrata duhet të anulohet, duke u shoqëruar me dënimet përkatëse dhe rregullimin e pasojave, që mund të përfshijë edhe dorëheqjen apo shkarkimin nga detyra të kryetarit të bashkisë.

